Për projektin nevojiten mbi 400 persona me kualifikime, moshë dhe përvojë të ndryshme. Në këtë fazë në të cilën gjendet tani zhvillimi i projektit pothuajse të gjithë personat e angazhuar në projekt dhe të punësuarit tanë janë nga Maqedonia

Steve Sharpe, kryetar dhe drejtor i kompanisë "Euromaks"

Miniera do të kushtojë 500 milionë dollarë

"Ndërtimi i minierës deri në vënien e saj në funksion do të kushtojë rreth 500 milionë dollarë, kurse do të punësohen rreth 400 persona,kurse në mënyrë indirekte do të angazhohen rreth 700 persona përmes nënkontraktuesve. Bëhet fjalë për një projekt të madh, që është i rëndësishëm për ne në Euromaks, por është edhe më i rëndësishëm për Republikën e Maqedonisë, sepse puna e saj do të ketë një efekt shumë pozitiv për ekonominë", thotë drejtorin ekzekutiv të "Euromaks", Steven Sharp

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 27 maj - Tre vite me parë u nënshkrua marrëveshja për koncesion për eksploatim të burimeve të bakrit dhe arit në minierën "Illovica" afër Strumicës midis kompanisë kanadeze "Euromaks" dhe Qeverinë së Republikës së Maqedonisë. Bëhet fjalë për një projekt shumë të madh dhe është investimi i parë Greenfield në ndërtimin e minierës së re në Maqedoni, ndërsa rëndësia e saj është aq e madhe nëse merret parasysh se ky është investimi i parë të këtij lloji në sektorin e xehetarisë në Ballkan pas më shumë se 30 vite. Për të mësuar më shumë se kur do të fillohet me ndërtimin e minierës "Illovica", sa kompani të huaja dhe vendore do të angazhohen në vënien në funksion të kësaj miniere, sa vende të reja pune do të hapen si dhe cilat do të jenë efekte pozitive për ekonominë vendore zhvilluam intervistë me kryetarin dhe drejtorin ekzekutiv të "Euromaks", Steven Sharp.

KOHA: Sa prej investimeve të paralajmëruara janë një imput për kompanitë e Maqedonisë, e sa për ato të huaja?

SHARPE: Miniera për ar dhe bakër Illovica është investimi i parë Greenfield në ndërtimin e minierës së re në Maqedoni, ndërsa rëndësia e saj është aq e madhe nëse merret parasysh se ky është investimi i parë i këtij lloji në sektorin e xehetarisë në Ballkan pas më shumë se 30 vite. Ndërtimi i minierës deri në vënien e saj në funksion do të kushtojë rreth 500 milionë dollarë, kurse do të punësohen rreth 400 persona, ndërsa në mënyrë indirekte do të angazhohen rreth 700 persona përmes nënkontraktuesve. Bëhet fjalë për një projekt të madh, që është i rëndësishëm për ne në Euromaks, por është edhe më i rëndësishëm për Republikën e Maqedonisë, sepse puna e saj do të ketë një efekt shumë pozitiv për ekonominë e Maqedonisë. Domethënë, një prej problemeve më të mëdha në vend, në të cilin janë fokusuar të gjithë faktorët politik është përmirësimi i gjendjes ekonomike të vendit. Gjithsesi, ky investim do të thotë punësime të reja dhe eksport më të madh nga Maqedonia, por gjithashtu do të ketë një efekt të rëndësishëm në rritjen dhe do ta stimulojë ekonominë e vendit, por edhe të rajonit. Sipas vlerësimeve, vlera e eksportit vjetor do të jetë rreth 300 milionë dollarësh, që në masë të madhe do ta zvogëlojë deficitin tregtar të vendit. Të gjitha burime e financimit janë në nivel ndërkombëtar. Përveç Euromaksit, në investimin e këtij projekti janë përfshirë edhe institucione të tjera shumë të rëndësishme, siç është Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), që ka pjesëmarrjen e vet në projekt me 20%, kompania amerikane Rojal Gold, që do të sigurojë 175 milionë dollarë dhe Fondi Gjerman Garantues (UFK - Garantien für Ungebundene Finanzkredite), i cili është i mbështetur nga Qeveria gjermane, kemi marrë një letër mandati për një pajtueshmëri parimore dhe autorizim për marrëveshjen e financimit prej 215 milionë dollarësh për financimin parësor të projektit nga ana e Sosietes Generale, UniCredit Bank AG dhe Unicredit Bank Austria AG, si kreditorë kryesorë. Kushti për marrjen e kësaj letre mandati është që pjesa më e madhe e xehes më tutje të sillet në shkritore që është në pronësi gjermane. Përveç kësaj, në kuadër të kësaj marrëveshjeje kreditore, janë kontraktuar edhe kushtet me Caterpillar Financial ("Cat Financial") për marrëveshje për financimin e pajisjes me vlerë prej më shumë se 25 milionë dollarë amerikanë.

KOHA: Sa dhe pse keni angazhuar kompani të huaja përkundër faktit se në Maqedoni ekzistojnë kompani që kryejnë të njëjtin biznes?

SHARPE: Në të vërtet nuk e di. Vetëm mund të flas për kompaninë tonë dhe për qasjen që e kemi dhe në të cilën fokusohemi. Siç potencova, përfitimin më të madh nga ndërtimi i minierës së arit dhe bakrit do ta kenë Republika e Maqedonisë dhe qytetarët e saj. Politika jonë është që të punësojmë persona nga rajoni dhe më gjerë, ndërsa atje ku ka dallim të madh në aftësitë do të angazhojmë ekspertë ndërkombëtarë që të mund të jemi të sigurt se dallimet e tilla do të plotësohen me trajnime adekuate dhe me transferim të aftësive ndaj qytetarëve të Maqedonisë. Për projektin nevojiten mbi 400 persona me kualifikime, moshë dhe përvojë të ndryshme. Në këtë fazë në të cilën gjendet tani zhvillimi i projektit pothuajse të gjithë personat e angazhuar në projekt dhe të punësuarit tanë janë nga Maqedonia. Në të ardhmen do të rritet në mënyrë drastike numri i personave të angazhuar, por edhe numri i kompanive nënkontraktuese, që është aq e rëndësishme për stimulimin e sektorit të biznesit si në nivel lokal ashtu edhe në nivel kombëtar.

KOHA: Angazhimi i kompanive të huaja për projekte të caktuara, në kushte të papunësisë së madhe në Maqedoni, do të thotë nënvlerësim të fuqisë punëtore të Maqedonisë?

SHARPE: Ne e vlerësojmë kapacitetin e njerëzve dhe kompanive këtu dhe fakti që këtu investojmë edhe ne edhe partnerët tanë investitorë shumë mirë e dëshmojnë këtë. Por, shembulli më i madh për këtë është fakti se para një kohe Euromaks e ka mbyllur zyrën e saj në Londër dhe u transferua në Maqedoni. Tani selia e kompanisë sonë është këtu në Shkup, kurse numri i të punësuarve është rritur në mënyrë përkatëse. Pozicionet ndërkombëtare korporative që më parë janë kryer nga stafi në Londër dhe Kanada tani kryhen tërësisht nga maqedonasit në Maqedoni. Kjo dërgon një mesazh të fortë për kapacitetin e njerëzve dhe kompanive në Maqedoni. Si do të hyjë projekti në një fazë të re ashtu do të rritet edhe numri i personave të angazhuar dhe kompanive të jashtme. Këtu do ta jepja shembullin e hulumtimit për karakteristikat socioekonomike të popullatës së fshatrave Illovica dhe Shutkë në komunën e Bosillovës. Muajin e kaluar këtë hulumtim e kanë zbatuar në teren studentë të fakultetit Goce Delçev nga Shtipi. Kështu që, ne do të vazhdojmë të punojmë në përputhje me të njëjtat parime. Dhe me fillimin e minierës në fund të vitit 2017 ajo do të shihet edhe më shumë.

KOHA: Si planifikoni t'i kompensoni dëmet e popullatës lokale kur miniera Illovica do të fillojë me punë, duke pasur parasysh se me minierën do të prishet paqja në rrethinë?

SHARPE: Për shkak se ky është një investim Greenfield, kjo minierë do të ndërtohet në përputhje me teknologjitë dhe praktikat më të fundit moderne që përdoren në botë. Kështu, punimi i minierës do të jetë në përputhje me rrethinën, që është shumë e rëndësishme për ne. E respektojmë tërësisht legjislacionin kombëtar në këtë fushë, i cili është i harmonizuar me atë të BE-së. Në të gjitha proceset e zhvillimit të minierës janë përfshirë tërësisht të gjitha institucionet relevante, kurse Studimi ynë për ndikimin e projektit për bakër dhe ar Illovica ndaj mjedisit është vlerësuar pozitivisht nga ana e Qeverisë së Maqedonisë. Tani jemi në fazën e përpunimit të studimit të fizibilitetit, i cili do të japë një garanci shtesë se të gjitha aktivitetet në Illovicë do të jenë në përputhje me ligjet dhe praktikat më të mira botërore. Ky është një aspekt shumë i rëndësishëm, i cili është një nga kushtet për hyrjen e partnerëve dhe kreditorëve seriozë në financimin e minierës. Përkujdesja për mjedisin sipas standardeve botërore është kushti kryesor për hyrjen e institucioneve BERZH dhe Royal Gold në projekt, dhe gjithsesi edhe lëshimi i garancisë dhe letrës së mandatit nga Fondi Gjerman Garantues është kushtëzuar me përmbushjen e standardeve më të larta ekologjike. Prezenca dhe pjesëmarrja e tyre në projekt janë një garanci të veçantë se bëhet fjalë për një projekt serioz i cili do të punojë sipas standardeve më të larta ekologjike, në përputhje me legjislacionin e Maqedonisë.

KOHA: A jeni të kënaqur me bashkëpunimin me popullatës lokale?

SHARPE: Ky projekt është i rëndësisë shumë të madhe në radhë të parë për popullatën lokale dhe për këtë arsye sjellja e tyre ndaj projektit ka një rëndësi të madhe për ne. Që nga fillimi i projektit dhe aktivitetet e para, me ndihmën e madhe të kryetarëve të Komunave të Bosillovës dhe të Novoselës, kemi vendosur një dialog të mirë me popullatën lokale. Personat e parë të angazhuar ishin pikërisht nga popullata lokale. Për të gjitha aktivitetet tona rregullisht i informojmë dhe i përfshijmë. Në fshatin Illovicë tashmë disa vite kemi hapur edhe një Info Qendër, e cila punon çdo ditë dhe atje banorët mund të informohen për të gjitha aspektet e projektit ose të parashtrojnë pyetje për të cilat menjëherë do të marrin përgjigje. Gjithashtu, kemi një bashkëpunim të shkëlqyer edhe me përfaqësuesit e pushtetit lokal, mbështetja dhe aktiviteti i të cilëve kanë një rëndësi të madhe për projektin.

KOHA: A jeni të kënaqur me bashkëpunimin me ministritë kompetente?

SHARPE: Ju faleminderit për pyetjen. Me të vërtetë dua të shpreh kënaqësinë time të madhe nga gatishmëria dhe kapaciteti i të gjitha ministrive dhe institucioneve relevante, përkatësisht nga tërë Qeveria për njohjen e rëndësisë së këtij projekti.

Pa mbështetjen e institucioneve, realizimi i projektit nuk do të ishte i mundur. Sidomos duke pasur parasysh se bëhet fjalë për një fushë në të cilën ekspeditivi administrativ luan një rol shumë të rëndësishëm. Pjesa më e madhe e kompetencave në këtë fushë janë te Ministria e Ekonomisë me të cilën kemi një bashkëpunim të shkëlqyer, kurse ata kanë një kuptim të madh për rëndësinë e këtij projekti për Republikën e Maqedonisë dhe për zhvillimin e ekonomisë kombëtare.

Një prej problemeve më të mëdha në vend, në të cilin janë fokusuar të gjithë faktorët politik është përmirësimi i gjendjes ekonomike të vendit. Gjithsesi, ky investim do të thotë punësime të reja dhe eksport më të madh nga Maqedonia, por gjithashtu do të ketë një efekt të rëndësishëm në rritjen dhe do ta stimulojë ekonominë e vendit, por edhe të rajonit